

# FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

## Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

*Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)*

INTERLOGISTIC

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

K21605003M

NUIS/NIPT

Autostrada Tirane-Durres, Rruga Dytesore Km 9, Godine 3 kateshe

Adresa

Tiranë

Albania

1001

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0692085141

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

info@ilog.al

E-mail

Administrator i deleguar Lorina Lako

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2023/05/08

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

+355696062914

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

## Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

*Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.*

REF-68004-05-02-2023

---

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

---

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Simple

---

Autoriteti/Enti Kontraktor

*Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.*

Ujesjelles-Kanalizime Kamez Sh.a

---

Vlera e përlogaritur e prokurimit

*Vlera e përlogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)*

2000000

---

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

*Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.*

Blerje Kancelari

---

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

*Data (viti/muaji/dita)*

2023/05/15

---

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

---

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

---

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Mallra

2023/05/15

---

Numri i njoftimit

Kodi CPV

REF-68004-05-02-2023

30125110-530192124-630192130-130197220-

---

Ankese mbi argument në KPP

---

### Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

#### 1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

1. Ligji nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar
  2. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285 date 19.05.2021 “Pe?r miratimin e Rregullave të prokurimin publik” i ndryshuar,
  3. Direktiva nr. 24/2014 “Pe?r prokurimin publik” Këshillit të Europës:
  4. Vendimi i KPP-së Nr. 249/2020, Vendimi 355/2020, vendimi 1209/2022 si dhe vendimi nr. 200/2022 datë 25.02.2022
- 

#### 2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit
- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsytet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavarëshmërinë)

- Tjetër

□

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

### 3. Rrethanat dhe faktet □

Përshkruani rrethanat e faktit. □

NR	Emërtimi	Specifikime teknike	Njesia	
1	Makine kapse deri 80 flete metalike		mak kapse 23/6-23/13(80 fl)	Copë
2	Makine kapse deri 25 flete metalike		mak. kapse 24/6-26/6(25 fl)	Copë
3	Stilolaps rapidograf	Stilolaps rapidograf me majë fine 0.3 mm, ngjyrë blu dhe rezistente ndaj ujit, drites dhe kohes, nuk zbehet dhe nuk lë njolla. Keto specifikime të jene të shkruara në trup, ose në katalogun e prodhuesit.		Copë
4	Gershere 15 cm	Gershere 140mm doreze gomine		Copë
5	Qese Celefoni	Zarfa Plastik A4, minimumi 90 micron, 100 cope/pako		Pako
6	Dosje kartoni të thjeshta të bardha		Dosje të thjeshta , karton jo më pak se 300gr/m2, të bardha .	Copë
7	Dosje me llastik ngjyra të ndryshme		Dosje me llastik (karton jo më pak se 450gr/m2).Ngjyrate ndryshme të kuqe, portokalli, lejla	Copë
8	Zarfa të vegjel A5 .Te jene me shirit ngjites	Zarfa 19x26		Copë
9	Zarfa 11x23 .Te jene me shirit ngjites	Zarfa 11x23		Copë
10	Zarfa A4.Te jene me shirit ngjites	Zarfa 23x33 (A4)		Copë
11	Zarfa të medhenj A3 .Te jene me shirit ngjites	Zarfa 30x40		Copë
12	Heqse telash pince metalike	Heqse telash pince metalike		Copë
13	Kapse aktesh të mesme	Kapse aktesh Nr.4(33mm), kuti me 100cp.		Kuti
14	Makina Llogaritse me 12 numra e madhe			Copë
15	Stilo cilesore me majë fine blu (rapid)			Copë
16	Kuti Arkive	Kuti arkive 500gr/m?		Copë
17	Dosje Arshive me lidhese	Dosje me lidhese 15 cm .		Copë
18	Dosje me mekanizem .	Dosje me mekanizem minimumi 7cm. Në brendesi të dosjes duhet të ketë dy xhepa për format A4 dhe një xhep për mbajtje CD-je. Materiali plastik ose ekuivalent, rezistent ndaj lageshtires.		Copë
19	Bisturi të mesme	Thike prerese		Copë
20	Telakapse staples 24/6	Tela24/6, pako 1000cp.		Pako
21	Vizore 50cm me mbajtese	Vizore 50cm me mbajtese		Copë
22	Kapse me vesha mesem	Kap.Akt.Veshe41mm	Pako/12cpPako	
23	Kapse me vesha të vogel	Kap.Akt.Veshe25mm	Pako/12cpPako	
24	Dosje me qese celefoni	Dosje A4 me 40 zarfa plastike		Copë
25	Leter A4 80gr/m2.	Leter A4 80gr/m?. Bardhesi CIE	= 160 Trashesi ?m	

=110.  
Lemueshmeri ml/min =120 Lageshti % =4  
Shkelqimi % =112 Drite % =95  
Ashpersia (aftesia) në perkulje MD, mN >95 Ashpersia (aftesia) në perkulje CD, MN >30

Rizma/ 500fl

- |    |   |  |      |
|----|---|--|------|
| 26 | Leter A3 80gr/m2.   | Rizma/ 500fl   |      |
| 27 | Ditar Shpenzimesh   | Copë   |      |
| 28 | Libra protokolli te medhenj me 200 flete  | Liber Magazine 400 flete, 24x33.5 cm                               | Copë |
| 29 | Bllloqe me ngjitje  | Bllloqe me ngjitje 76x76 mm me 500 fletë                           | Copë |
| 30 | Bllloqe Axxhende 2023, permasa ~17x24   | Copë   |      |
| 31 | Regjister korrenspondence   | Regjister korespondence 200fl                                      | Copë |
| 32 | Liber sherbimi (depo) me 100 fl   | Copë   |      |
| 33 | Flamuj shqipetar i madh per ambjent. Jashte   | 90x148cm   | Copë |
| 34 | Flamur i madh me logo UKKsha per ambjentet jashte   | 90x148cm   | Copë |
| 35 | Kalendar  | Kalendar Tavoline2023  | Copë |
| 36 | Mandate pagese  | Copë   |      |
| 37 | Liber Arke  | Liber arke 100 flete   | Copë |
| 38 | Bllloqe mandat arketimi me tre kopje me numer serial  | Mandat arketimi 3C madh me nr. serial                              | Copë |
| 39 | Bllloqe flet hyrje me tre kopje me numer serial   | Blllok Flete Hyrje me 3C (Nr serial)                               | Copë |
| 40 | Bllloqe flet dalje me tre kopje me numer serial   | Blllok Flete Dalje me 3C (Nr serial)                               | Copë |
| 41 | Liber magazine me 500 flete   | Liber Magazine 400 flete   | Copë |
| 42 | Liber laborator   | Copë   |      |
| 43 | Liber per proces verbal depo  | Copë   |      |
| 44 | Boje vule   | Boje Vule~30ml Blu   | Copë |
| 45 | Tampon vule   | Tampon Vule~ 12x8 cm   | Copë |
| 46 | Tela Aktesh ( paper clips )   | Kapese Aktesh Nr. 3, 28mm  | Kuti |
| 47 | USB 32 giga 3.0   | Usb 32GB 3.0   | Copë |
| 48 | USB 64 giga 3.0   | Usb 64GB 3.0   | Copë |
| 49 | Dosje me buton rezistent ndaj lageshtires.  | Dosje me buton 16 cm, me doreze. Materiali plastik ose ekuivalent, | Copë |
| 50 | Flamuj zyre me mbajtese (shqiptar)  | Copë   |      |
| 51 | Flamuj zyre me mbajtese (logo UKK sha)  | Copë   |      |
| 52 | Mbajtese kancelarie   | Copë   |      |
| 53 | Paste per CPU   | Copë   |      |
| 54 | Lapsa te zinj me majë të përforcuar   | Lapsa grafiti, me fortësi të vijës 2B, prej materiali druri,       | Copë |
| 55 | Goma  | Copë   |      |
| 56 | Korektor  | Korrektor stilo 8ml  | Copë |
| 57 | CD (Pako 100 copë)  | Te mbajnë deri në 700 Mb ose 80 minuta regjistrim                  | Pako |
| 58 | Bllloqe shenimesh   | Blllok shenimesh A5 (minimumi 98 fl, imitim lekure)                | Copë |
| 59 | Prerese lapsash   | Prehese metalike   | Copë |
| 60 | Ngjitese letre rulo   | Skoc 19x33   | Copë |
| 61 | Color hije brush (evidencjator me ngjyra te ndryshme)   | Copë   |      |
| 62 | Vinovil   | Vinovil 80 ml  | Copë |
| 63 | Ngjites stik  | 21gr 21 Gr   | Copë |
| 64 | Dosje me kater unaza me zinxhir, imitim lekure, me doreza. Ne pjesen e jashteme te kete minimumi dy xhepa te medhenj ~ A4. Ne pjesen e brendshme te jete e pajisur me bllok A4, vend per mbajtese stilolapsi, nje xhep per format A4 dhe disa xhepa te vegjel per kartvizita. | Dosje me kater unaza   | Copë |
| 65 | Toner per Canon   | Canon 6065 I   | Copë |
| 66 | Toner per Aficio  | Aficio MP-C300Set  |      |

67	Toner per Aficio	Aficio MP-171	Copë	
68	Toner per Canon	Canon IR-1024	Copë	
69	Toner per Lexmark	Lexmark MS317 DN	Copë	
70	Toner per Brother	Brother DCP-L8410	Set	
71	Toner per Xerox	Xerox B1025	Copë	
72	Toner per Ricoh	Ricoh SP-311 DN	Copë	
73	Toner per Brother	Brother HL-L8260 CDW	Set	
74	Toner per Brother	Brother HL-L6250 DN	Copë	

#### 4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

*Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.*

Të nderuar zotërinj

Shoqëria “Interlogistic” Sh.p.k me Nipt K21605003M përfaqësuar nga Administratori i Përgjithshëm Z. Edmond Hido, në vijim të procedurës së prokurimit publik “Procedure e hapur e thjeshtuar”, shpallur nga Autoriteti Kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Kamëz Sh.a, me objekt: “Blerje Kancelari”, me numer REF-68004-05-02-2023, me fond limit 2,000,000 (dy milion) Lekë pa TVSH, publikuar më datë 03.05.2023, referuar në afatin 7 (shtatë) ditor të parashikuar nga Ligji nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik“ konkretisht Neni 110 pika 2 i cili citon “Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”, lidhur me të drejtën e ankimit pas publikimit të dokumenteve standarte të tenderit, po ju parashtrijmë në vijim arsyet ligjore ku bazohen këto kundërshtime: Në shtojcën 5 “Specifikimet teknike” është kërkuar nga ana Juaj si më poshtë:

NR	Emërtimi	Specifikime teknike	Njesia	
1	Makine kapse deri 80 flete metalike		mak kapese 23/6-23/13(80 fl)	Copë
2	Makine kapse deri 25 flete metalike		mak. kapese 24/6-26/6(25 fl)	Copë
3	Stilolaps rapidograf	Stilolaps rapidograf me majë fine 0.3 mm, ngjyrë blu dhe rezistente ndaj ujit, drites dhe kohes, nuk zbehet dhe nuk lë njolla. Keto specifikime te jene te shkruara ne trup, ose ne katalogun e prodhuesit.		Copë
4	Gershere 15 cm	Gershere 140mm doreze gomine		Copë
5	Qese Celefoni	Zarfa Plastik A4, minimumi 90 micron, 100 cope/pako		Pako
6	Dosje kartoni te thjeshta te bardha		Dosje te thjeshta , karton jo me pak se 300gr/m2, te bardha .	Copë
7	Dosje me llastik ngjyra te ndryshme		Dosje me llastik (karton jo me pak se 450gr/m2).Ngjyrate ndryshme te kuqe, portokalli, lejla	Copë
8	Zarfa te vegjel A5 .Te jene me shirit			
ngjites	Zarfa 19x26			Copë
9	Zarfa 11x23 .Te jene me shirit			
ngjites	Zarfa 11x23			Copë
10	Zarfa A4.Te jene me shirit			
ngjites	Zarfa 23x33 (A4)			Copë
11	Zarfa te medhenj A3 .Te jene me shirit			
ngjites	Zarfa 30x40			Copë
12	Heqse telash pince metalike	Heqse telash pince metalike		Copë
13	Kapse aktesh te mesme	Kapse aktesh Nr.4(33mm), kuti me 100cp.		Kuti

- 14 Makina Llogaritse me 12 numra e madhe Copë  
 15 Stilo cilesore me majë fine blu (rapid) Copë  
 16 Kuti Arkive Kuti arkive 500gr/m? Copë  
 17 Dosje Arshive me lidhese Dosje me lidhese 15 cm . Copë  
 18 Dosje me mekanizem . Dosje me mekanizem minimumi 7cm. Ne brendesi te dosjes duhet te kete dy xhepa per format A4 dhe nje xhep per mbajte CD-je. Materiali plastik ose ekuivalent, rezistent ndaj lageshtires. Copë  
 19 Bisturi te mesme Thike prerese Copë  
 20 Telakapse staples 24/6 Tela24/6, pako 1000cp. Pako  
 21 Vizore 50cm me mbajtese Vizore 50cm me mbajtese Copë  
 22 Kapse me vesha mesem Kap.Akt.Veshe 41mm Pako/12cpPako  
 23 Kapse me vesha te vogelKap.Akt.Veshe 25mm Pako/12cpPako  
 24 Dosje me qese telefoni Dosje A4 me 40 zarfa plastike Copë  
 25 Leter A4 80gr/m2. Leter A4 80gr/m?. Bardhesi CIE = 160 Trashesi ?m =110.

Lemueshmeri ml/min =120 Lageshti % =4

Shkelqimi % =112 Drite % =95

Ashpersia (aftesia) ne perkulje MD, mN >95 Ashpersia (aftesia) ne perkulje CD, MN >30 Rizma/ 500fl

- 26 Leter A3 80gr/m2. Rizma/ 500fl  
 27 Ditar Shpenzimesh Copë  
 28 Libra protokolli te medhenj me 200 flete Liber Magazine 400 flete, 24x33.5 cm Copë  
 29 Blloqe me ngjitje Blloqe me ngjitje 76x76 mm me 500 fletë Copë  
 30 Blloqe Axhende 2023, permasa ~17x24 Copë  
 31 Regjister korrenspondence Regjister korespondence 200fl Copë  
 32 Liber sherbimi (depo) me 100 fl Copë  
 33 Flamuj shqipetar i madh per ambjent. Jashte 90x148cm Copë  
 34 Flamur i madh me logo UKKsha per ambjentet jashte 90x148cm Copë  
 35 Kalendar Kalendar Tavoline2023 Copë  
 36 Mandate pagese Copë  
 37 Liber Arke Liber arke 100 flete Copë  
 38 Blloqe mandat arketimi me tre kopje me numer serial Mandat arketimi 3C madh me nr. serial Copë  
 39 Blloqe flet hyrje me tre kopje me numer serial Bllok Flete Hyrje me 3C (Nr serial) Copë  
 40 Blloqe flet dalje me tre kopje me numer serial Bllok Flete Dalje me 3C (Nr serial) Copë  
 41 Liber magazine me 500 flete Liber Magazine 400 flete Copë  
 42 Liber laborator Copë  
 43 Liber per proces verbal depo Copë  
 44 Boje vule Boje Vule ~30ml Blu Copë  
 45 Tampon vule Tampon Vule ~ 12x8 cm Copë  
 46 Tela Aktesh ( paper clips ) Kapese Aktesh Nr. 3, 28mm Kuti  
 47 USB 32 giga 3.0 Usb 32GB 3.0 Copë  
 48 USB 64 giga 3.0 Usb 64GB 3.0 Copë  
 49 Dosje me buton Dosje me buton 16 cm, me doreze. Materiali plastik ose ekuivalent, rezistent ndaj lageshtires. Copë  
 50 Flamuj zyre me mbajtese (shqiptar) Copë  
 51 Flamuj zyre me mbajtese (logo UKK sha) Copë  
 52 Mbajtese kancelarie Copë

53	Paste per CPU	Copë		
54	Lapsa te zinj me majë të përforcuar	Lapsa grafiti, me fortësi të vijës 2B, prej materiali druri, Copë		
55	Goma	Copë		
56	Korektor	Korrektor stilo 8ml	Copë	
57	CD (Pako 100 copë)	Tembajnë deri në 700 Mb ose 80 minuta regjistrim		Pako
58	Bloqe shenimesh	Bloq shenimesh A5 (minimumi 98 fl, imitim lekure)		Copë
59	Prerese lapsash	Prehese metalike	Copë	
60	Ngjitese letre rulo	Skoc 19x33	Copë	
61	Color hije brush (evidencjator me ngjyra te ndryshme)			Copë
62	Vinovil	Vinovil 80 ml	Copë	
63	Ngjites stik	21gr21 Gr	Copë	
64	Dosje me kater unaza me zinxhir, imitim lekure, me doreza. me zinxhir, imitim lekure, me doreza. Ne pjesen e jashteme te kete minimumi dy xhepa te medhenj ~ A4. Ne pjesen e brendshme te jete e pajisur me bllok A4, vend per mbajttese stilolapsi, nje xhep per format A4 dhe disa xhepa te vegjel per kartvizita.			Dosje me kater unaza Copë
65	Toner per Canon	Canon 6065 I	Copë	
66	Toner per Aficio	Aficio MP-C300Set		
67	Toner per Aficio	Aficio MP-171	Copë	
68	Toner per Canon	Canon IR-1024	Copë	
69	Toner per Lexmark	Lexmark MS317 DN	Copë	
70	Toner per Brother	Brother DCP-L8410	Set	
71	Toner per Xerox	Xerox B1025	Copë	
72	Toner per Ricoh	Ricoh SP-311 DN	Copë	
73	Toner per Brother	Brother HL-L8260 CDW	Set	
74	Toner per Brother	Brother HL-L6250 DN	Copë	

Këto specifikime në lidhje me artikujt e lartpërmendur nuk e justifikojnë qëllimin për të cilin janë vendosur, pasi specifikime teknike të tilla nuk garantojnë cilësinë ose standartin e lartë për këtë produkt. Ndër të tjera konstatojmë se specifikimet teknike të artikujve të sipërpërmendur, të përcaktuara nga ana AK janë kufizuese, diskriminuese dhe nuk garantojnë të drejtën e operatorëve ekonomike të interesuar për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi.

Theksojmë se për të shmangur një situatë të tillë e cila të bën të mendosh se AK mund të adresojë në një markë të caktuar apo po kufizon konkurrencën, duhet të parashikoni specifikime për artikujt e mësipërm me një rang më të madh të parametrave duke përcaktuar një marzh me të gjerë specifikimesh e cila krijon mundësinë e ofertimit të artikujve të ndryshem por gjithmonë cilësore nga operatorë ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi.

Sa më sipër, përcaktimi nga autoriteti kontraktor i specifikimeve për artikullin nr. 3 “Stilolaps rapidograf” me specifikime teknike “Stilolaps rapidograf me majë fine 0.3 mm, ngjyrë blu dhe rezistente ndaj ujit, drites dhe kohes, nuk zbehet dhe nuk lë njolla. Keto specifikime te jene te shkruara ne trup, ose ne katalogun e prodhuesit.” na detyron që të kërkojmë nga autoriteti kontraktor që për këtë artikull të ndryshojë togfjalëshi “Keto specifikime te jene te shkruara ne trup, ose ne katalogun e prodhuesit” pasi vendosja e specifikimeve teknike në trupin e produktit është politikë e prodhuesit dhe ne si tregtarë nuk mund të influenciojmë se ku do jenë të pranishme specifikimet teknike. Prandaj kërkojmë që ky specifikim teknik të ndryshojë duke i dhënë mundësi çdo ofertuesi të marrë pjesë në procedure.

Në lidhje me artikullin nr. 4 “Gershere 15 cm”, me specifikime teknike “Gershere 140mm doreze gomine” kërkojmë nga ana e grupit të shqyrtimit të ankesës që të specifikohet permasa 15 cm apo



14 cm pasi kanë kosto te ndryshme.

Në lidhje me artikullin nr. 15 “Stilo cilesore me majë fine blu (rapid)”, kërkojmë nga ana e grupit të shqyrtimit të ankesës që të përcaktohet maja 0.5mm apo 0.7mm.

Për artikullin nr. 21 “Vizore 50cm me mbajtese”, me specifikime teknike “Vizore 50cm me mbajtese” kërkojmë nga ana e grupit të shqyrtimit të ankesës që të hiqet termi mbajtëse, pasi nuk ndikon ne funksionalitetin e produktit.

Përsa i përket specifikimeve teknike të artikullit letër format A4 80 gr/m2 të kërkuara nga ana e juaj, janë kufizuese konkretisht specifikimi, Shkelqimi =112 %.

Përcaktimi i mësipërm i AK është kufizues, diskriminues dhe nuk garanton të drejtën e OE të interesuar për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi. Këto specifikime në lidhje me artikullin e lartpërmendur nuk e justifikojnë qëllimin për të cilin është vendosur, pasi specifikime teknike të tilla nuk garantojnë cilësinë ose standartin e lartë për këtë produkt.

Theksojmë se për të shmangur një situatë të tillë e cila të bën të mendosh se AK mund të adresojë në një markë të caktuar apo po kufizon konkurrencën, duhet të parashikoni specifikime të letrës me një rang më të madh të parametrave duke përcaktuar një marzh me të gjerë me minimum dhe maksimum duke krijuar mundësinë e ofertimit të letrave të ndryshme por gjithmonë cilësore nga operatorë ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi.

Sa më sipër kërkojmë nga ana e AK që specifikimi i ankimuar më lart të bëhet Shkelqimi 100-115 %.

Ky pretendim i joni përcaktohet dhe nga vendimi i KPP-së Nr. 249/2020, Vendimi 355/2020, vendimi 1209/2022 si dhe vendimi nr. 200/2022 datë 25.02.2022.

Nga sa më sipër kërkojmë që të informoheni mbi llojet e letrës që ekzistojnë dhe të bëni përcaktimet e sakta për artikullin letër që ju kërkoni. Gjithashtu në lidhje me artikullin “Leter A4” duhet të mbani parasysh që Autoretitet Kontraktore kur hartojnë / publikojnë një procedurë prokurimi, duhet të mbajnë në vëmendje përcaktimet ligjore në lidhje me kriteret e vendosjes së parametrave për artikujt që prokurojnë. Këto parametra të vendosura për artikujt e mësipërm janë parametra të cilat nuk garantojnë pjesëmarrjen e të gjithë operatoreve ekonomike të interesuar në këtë procedurë prokurimi dhe nuk lidhen me garantimin e cilesise se produktit, pasi ky produkt mund te ofrohet me te njejtin standart cilësie dhe duke pasur një marzh më gjërë parametrash në minimum”

Përsa i përket artikullit nr. 27 “Ditar Shpenzimesh”, kërkojmë të përcaktohen numri i fleteve dhe madhësia.

Për artikullin nr. 28 “Libra protokolli te medhenj me 200 flete” me specifikime teknike “Liber Magazine 400 flete, 24x33.5 cm” kërkojmë të specifikohet nëse kërkohet liber protokolli me 200 flete apo liber magazine me 400 flete pasi jane 2 artikuj të ndryshëm me kosto te ndryshme, dhe madhesi të ndryshme.

Në lidhje me artikullin nr. 29 “Bllloqe me ngjitje” me specifikime teknike “Bllloqe me ngjitje 76x76 mm, me 500 fletë” kërkojmë nga autoriteti kontraktor që të vendoset min/max fletesh.

Në lidhje me artikullin nr. 31 “Regjister korrespondence” dhe artikullin nr. 32 “Liber sherbimi (depo) me 100 fl”, kërkojmë të përcaktohen madhesia A4 apo A5.

Për artikullin nr. 36 “Mandate pagese” të përcaktohet që artikulli të ketë numer serial apo jo dhe sa kopje.

Për artikullin nr. 41 “Liber magazine me 500 flete” me specifikime teknike “Liber Magazine 400 flete” të përcaktohet numri i fleteve 500 flete apo 400 flete pasi kanë kosto të ndryshme.

Për artikullin nr. 42 “Liber laborator” dhe artikullin nr. 43 “Liber për proces verbal depo”, kërkojmë të përcaktohen madhësia A4 apo A5

Për artikullin nr. 49 “Dosje me buton” me specifikime teknike “Dosje me buton 16 cm, me doreze. Materiali plastik ose ekuivalent, rezistent ndaj lageshtires”, kërkojmë të vendoset marzh përsa i përket përmasave. Dosjet standarte që janë në treg janë 15 cm. Gjithashtu kërkojmë hiqet termi plastik.

Ndërsa për artikullin nr. 50 “Flamuj zyre me mbajtese (shqiptar)” dhe artikullin nr. 51 “Flamuj zyre me mbajtese (logo UKK sha)”, kërkojmë të përcaktohen përmasat e artikullit pasi ndikojnë në kosto.

Kurse për artikullin nr. 64 “Dosje me kater unaza me zinxhir, imitim lekure, me doreza” me specifikime teknike “Dosje me kater unaza me zinxhir, imitim lekure, me doreza. Ne pjesen e jashteme te kete minimumi dy xhepa te medhenj ~ A4. Ne pjesen e brendshme te jete e pajisur me bllok A4, vend per mbajtese stilolapsi, nje xhep per format A4 dhe disa xhepa te vegjel per kartvizita”, konkludojmë që specifikimet teknike të artikullit të vendosura nga ana e AK të drejtojnë drejt një marke/artikulli të caktuar. Përsa më sipër kërkojmë që të rishikohen specifikimet në mënyrë që të mund të ofertojnë lloje të ndryshme dosjesh me unaza. Gjithashtu kërkojmë që të hiqet elementi “doreza” pasi nuk ndikon në funksionalitetin e produktit, si dhe të hiqen xhepat e jashtem, si dhe të vendoset min max unazash 2-4 unaza.

Gjithashtu referuar procesverbalit për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, gjucojmë se autoriteti kontraktor në asnjë rast nuk ka argumentuar teknikisht se si ndikojnë specifikimet teknike të atakuara nga ana jonë, në funksionalitetin e artikujve dhe çfarë pasojash sjell në përdorimin e këtij artikujve modifikimi i këtyre specifikimeve. Në këtë kuadër, pasi evidentuam gjithë bazën ligjore që është shkelur nga ana e Autoritetit Kontraktor në hartimin e këtyre specifikimeve lidhur me artikullin e lartpërmendur, pretendojmë, se autoriteti kontraktor duhet të pranojë pretendimet e sipëcekura në mënyrë që të rrisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Duke analizuar zë më zë artikujt e lartpërmendur, ne pretendojmë se vendosja e këtyre specifikimeve teknike bie në kundërshtim siç vijon:

? Në nenin 36 të ligjit nr. 162/2020 ‘Për prokurimin Publik’ përcaktohet se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë

që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë, në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të

përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pike 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të

shoqërohet nga fjalejt "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalejt "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pike 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pike 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor."

Gjykojmë se, është e nevojshme të ndalemi në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike.

Nga interpretimi i zgjeruar i dispozitës së mësipërme sipas metodës Lex specialis, autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës.

Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, 2 Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm.

Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, gjykojmë se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike.

Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën.

Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve.

Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionale sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikeve 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit.

Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

? Gjithashtu vendosja e specifikimeve të tilla bie në kundërshtim me nenin 42 të

Direktiveve 24/2014 “Për prokurimin publik” Këshillit të Europës, ku parashikohet se:

“Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojcës VII do të përcaktohen në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat, që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”.

Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: specifikim teknik nënkupton njërin nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një

dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdoruesdhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit;

Në vendimin e GJED çështja C-368/10 “Komisioni Europian vs. Mbretëria e Hollandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”

Në gjykojmë se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” se qëllimi i ligjit të prokurimit publik si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

Në këtë kuadër, pasi evidentuam gjithë bazën ligjore që është shkelur nga ana e Autoritetit Kontraktor në hartimin e këtyre specifikimeve lidhur me artikullin e lartpërmendur, pretendojmë, se autoriteti kontraktor duhet të pranojë pretendimet e sipërcekura në mënyrë që të rrisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

\*\*\*

Për të gjitha sa u parashtruan më sipër, në zbatim dhe përputhje me Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285 date 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, vendimi i KPP-së Nr. 249/2020, Vendimi 355/2020, vendimi 1209/2022, vendimi nr. 200/2022 datë 25.02.2022, si dhe Direktiva nr. 24/2014 “Për prokurimin publik” Këshillit të Europës, kërkojmë që Autoriteti Kontraktor, Ujësjetës Kanalizime Kamëz Sh.a dhe Komisioni i Prokurimit Publik, të ndryshojnë specifikimet e artikujve të sipërpërmendur si të pabazuara në ligj dhe në prova në mënyrë që të rrisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,  
Tiranë me 08.05.2023

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po      Jo  
?      X

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)

---

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

JO

---

7. Lista e informacionit konfidencial:

NA

---

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Nr. i faksit:

E-mail:

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/ Përfaqësuesi i autorizuar

**5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme**

Po

Jo

*(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkon)*

---

**6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:**

JO

---

**7. Lista e informacionit konfidencial:**

NA

---

*Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

***Kujdes: Ankimesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik***

---

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

**Nr. i faksit:**

**E-mail:**

info@ilog.al

**Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit**

**Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar**

Edmond Hido